

Emër Mbiemër: **Bardhyl Golemi**
Datëlindje: **1932**
Vendlindje: **Dhrovjan, Sarandë**
Viti i zgjedhjes: **1999**
Seksioni: **Shkencat natyrore dhe teknike**
Gjuhët : **Frëngjisht, rusisht, gjermanisht, italisht**
Kontakt : **069 22 49 910**



Adresa: Rr. "Ismail Qemali", P.77, Shk. 1, Ap. 1 Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 04 226 55 46
E-mail: bardhygolemi@live.com

CV e shkurtër

Mbaroi gjimnazin me "Medaljen e Artë", Institutin e Lartë Politeknik me diplomën "Shkëlqyer", ka plotësuar kulturën universitare në matematikë e fizikë në fakultetin përkatës, ka dëgjuar leksione pasuniversitare nga profesorë rusë dhe francezë. Ka kryer një specializim shkencor në Francë.

Kualifikimi: "Docent", "Doktor i shkencave", "Profesor", anëtar i Akademisë, sot "Akademik".
Përdor gjuhët: frënge, ruse, italiane dhe gjermane.

Ka punuar si ligjërues, shef katedre, drejtues i procesit mësimor në Universitetin e Tiranës , sekretar shkencor dhe kryetar në Seksionin e shkencave natyrore e teknike në Akademinë e Shkencave, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit (për probleme të përmbajtjes shkencore-pedagogjike edhe pse nuk ka qenë anëtar partie); për vite me radhë, anëtar i këshillave shkencorë, i kolegjiumeve, senateve etj. Ka kontribute në studimin e problemeve të shkollës dhe të shkencës, në organizimin e mjaft aktiviteteve mbi pedagogjinë e aplikuar me arsimitarë në shkallë kombëtare, në lidhje me eksperimentin shkencor në shkollë etj.

Ka kryer për 8 vjet detyrën e kryetarit të Komisionit Kombëtar të UNESCO-s për Shqipërinë me pjesëmarrjen aktive në konferenca ndërkombëtare , rajonale dhe kombëtare të saj. Ka punuar për 55 vjet si titullar në BTE, i fushave : Teoria e qarqeve, Teoria e fushës elektromagnetike, në Sinteza e qarqeve, dhe vitet e fundit, Bioelektromagnetizmi. Në Universitetin e Prishtinës ka mbajtur ligjërata sistematike, problemore, referime etj. Gjatë karrierës së tij ka kontribuar në përgatitjen e rreth 75 brezave të inxhinierëve; në udhëheqjen e dhjetëra diplomave, të disa doktoratave etj. Edhe sot aktivizohet në mësim dhe në shkencë. Është autor dhe bashkautor i shumë kurrikulave pedagogjike-shkencore të nivelit universitar dhe pasuniversitar. Ka drejtuar programe të veçanta në Shkollën e masterit shkencor dhe atë doktorale, në Fakultetin e Inxhinierisë etj. Ka punuar gjatë në fushën e lëkundjeve të qarqeve elektrike, të rezonancës dhe ferronancës, të teorisë së qarqeve etj., dhe ka mjaft publikime, artikuj shkencorë të botuar, referenca te veçanta në shtypin e huaj, studime e projekte të ndryshme etj. Është në bordin drejtues të revistës shkencore ndërkombëtare «JAE» dhe në bordin e revistës shkencore JNTS të ASHSH.

Ka marrë vlerësimet: «Qytetar Nderi» i Vlorës, Urdhrin "Naim Frashëri" kl.II, Urdhrin "Flamuri i Kuq", atë të "Punës" kl. II, «Çmimi i Republikës" kl.I.

3) PUBLIKIMET KRYESORE

a) Në nivelin e monografisë:

1. *“Njeriu elektromagnetik” në mjedisin elektromagnetik.* Bardhyl Golemi, Tiranë 2014, Akademia e Shkencave e Shqipërisë), 224 fq. ISBN 978-99956-10-67-8)
2. *Vala ,Celulari dhe Shëndeti* Bardhyl Golemi, Rozeta Miho. Tiranë, 2007. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, 270 fq.
3. *Fusha elektromagnetike dhe shëndeti.* Bardhyl Golemi. Tiranë, 2004. Universiteti Politeknik i Tiranës, 267 fq.)
4. *Mbi lëkundjet elektrike në rrjetat 35 Kv të shkaktuara nga transformatorët e tensionit.* Bardhyl Golemi, Bahri Radheshi. Tiranë 1977. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë, Shtypshkronja e Universitetit

b) Në nivelin e një traktati:

- 1) *Bazat teorike të Elektroteknikës.* Bardhyl Golemi. Universiteti Politeknik i Tiranës
- 1.1) Pjesa e tretë, 436 fq. A4 ,SHBLU, ISBN 99927-0-121. Bardhyl Golemi. Tiranë 2001
- 1.2) Pjesa e dytë, 409 fq., Shtyp MNS, Bardhyl Golemi. Tiranë 1999
- 1.3) Pjesa e parë, 459 fq., SHBLU ISBN99927-0-394-6. Bardhyl Golemi. Tiranë 1998

c) Në nivelin e botimeve dhe ripunimeve universitare

- 1) *Sinteza e qarqeve elektrike.* Bardhyl Golemi Tiranë 1981 (Universiteti i Tiranës, Fakulteti I Inxhinierisë) Shtyp. Kombinati Poligrafik Tiranë. 250 fq.
- 2) *Teoria e fushës elektromagnetike.* Red. shkencor Bardhyl Golemi. Autorë Pirro Cipo, Arben Tashko. Tiranë 1982. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë., Shtypshkronja e Universitetit, 270 fq.
- 3) *Teoria e fushës elektromagnetike.* Bardhyl Golemi. Tiranë 1980 (përkthim dhe përshtatje) Shtyp. Revista- Dispensa).
- 4) *Tekste të ripunuara,* tri ripunime BTE I II III. 1973; 1984; 1986. Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja e dispensave të Universitetit.
- 5) *Praktikum i Bazave Teorike të Elektroteknikës.* Bardhyl Golemi, Pirro Cipo. Tiranë 1974 Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë.
- 6) *Përmbledhje ushtrimesh dhe problemash,* Bardhyl Golemi etj. Tiranë 1968. 200 fq.

d) Publikime të tjera

- 1) *Universiteti i Tiranës 1957-2007,* Bardhyl Golemi Ethem Likaj, Osman Kraja, Zyhri Bajrami. Tiranë 2007. Universiteti I Tiranës Red. Ethem Likaj, Konsulent G. Karapici, Nestor Thereska. Shtëpia botuese “Morava”. ISBN99946 -628-3-7. Fq 107.

2).*Shkolla Shqiptare e Elektroteknikës*. Reiz Cani, Bardhyl Golemi. Fq 117. Tiranë 2004. Shtëpia botuese "PEGI".

3) *Zhvillimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri*. Vladimir Misja, Bardhyl Golemi. Tiranë 1986. Universiteti i Tiranës . 250 fq.

4).*Universiteti Shtetëror i Tiranës 1957-1967*. Luan Omari, Stefanaq Pollo, Bardhyl Golemi. Tiranë. 1967. Universiteti Shtetëror i Tiranës, 157 fq.

e) Studime dhe projekte

1) *Llogaritja dhe vlerësimi teorik në mjedis të rrezatimit të fushës elektromagnetike, në afërsi të stacioneve BT 2G dhe 3G të kompanisë Vodafone Albania për qarkun e Tiranës*. Bardhyl Golemi, Rozeta Miho, Bexhet Kamo, Olimpjon Shurdi, Sanije Cela. Tiranë 2012.

2) *Mbi lëkundjet në qarkun e thjeshtë ferrozonues dhe në sistemin me neutral të izoluar të shkaktuara nga transformatorët e tensionit*. Tezë doktrate. Tiranë 1978 (Depozituar në Bibliotekën Kombëtare dhe në Bibliotekën e Universitetit Politeknik).

4) *Panorama e rrezatimit elektromagnetik në Tiranë*. Bardhyl Golemi (udhëheqës) Egi Taga. 105 fq. (Tezë diplome), Tiranë 2010.

5) *Depistimi i fushave elektromagnetike të linjave të tensionit të lartë në Shqipëri*. Tiranë 2009. Bardhyl Golemi (udhëheqës), Edlire Dushi, 166 fq. Arkivi i Departamentit të sistemeve të fuqisë.

f) Artikuj shkencorë (disa prej tyre)

1) *Vështrime relativiste për valën elektromagnetike plane të para në sensin inxhinierik*. Bardhyl Golemi (Paraqitur në Konferencën ndërkombëtare në Metsovo, Greqi, me përmbledhjen përkatëse të punimeve të saj dhe në revistën IAE 1992).

2) *Përftimi i modelit matematikor për disa qarqe lëkundëse trifazore*. Bardhyl Golemi (Buletini i Shkencave Teknike, nr. 3, 1982).

3) *Një shfaqje e ferrozonancës në sistemin energjetik*. Bardhyl Golemi, Petraq Vasili. (Buletini i Shkencave Teknike, 1982).

4) *Mbi gjendjen dhe detyrat në fushën e shkencave elektroenergjetike*. Bardhyl Golemi, Llazar Papjorgji. etj. (Përmbledhje punimesh të Akademisë së Shkencave, referuar në seancën plenare. 1977).

5) Abstrakte të dy artikujve për ferrozonancën , janë referuar në revistën: "Referativni zhurnal" botim i Akademisë së Shkencave të ish-BS, 1976.

6) *Studim statistikor-eksperimental i ndikimit të kushteve fillestare në qarkun që përmban një bobinë me bërthamë çeliku të lidhur në seri me një kondensator*. Bardhyl Golemi (Buletini i Shkencave Teknike, nr. 1, 1976).

7) *Metodikë e përgjithshme për zgjidhjen e një ekuacioni diferencial jolinear të rendit n.* Bardhyl Golemi (Buletini i Shkencave Teknike, nr. 1, 1968)